



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE  
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 103/1 prot.

Tiranë, më 15.01.2025

Lënda: Dhënie mendimi mbi *“Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Presidencës së Sigurimit të Shtetit të Mbretërisë së Arabisë Saudite”*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**

**Tiranë**

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar kërkesën tuaj të datës 13.01.2025, dërguar përmes postës elektronike, protokolluar me tonën nr. 103 prot., datë 14.01.2025, me anë të të cilës dërgoni për mendim *“Marrëveshjen e Bashkëpunimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Presidencës së Sigurimit të Shtetit të Mbretërisë së Arabisë Saudite mbi luftimin dhe financimin e terrorizmit”* (në vijim *“Marrëveshja”*).

Nga shqyrtimi i materialit të dërguar, parashikohet nënshkrimi i një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet shteteve palë, në kuadër të bashkëpunimit policor dhe luftës kundër terrorizmit.

Duke qenë se, gjatë zbatimit të marrëveshjes, shtetet palë do të shkëmbejnë informacion, i cili përmban të dhëna personale, Zyra e Komisionerit sugjeron që, në nenin 5 të marrëveshjes, të parashikohet një pikë shtesë, me përmbajtje si vijon.

*“5. Kërkesat për bashkëpunim policor dhe shkëmbimi i informacionit të kërkuar i nënshtrohen rregullave dhe parimeve bazë të legjisllacioneve për mbrojtjen e të dhënave personale të shteteve palë në këtë marrëveshje”.*

Me reflektimin e propozimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit e vlerëson marrëveshjen, të hartuar konform legjisllacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**